Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

UNITED NATIONS ALBANIA

UNDP

PLANI SOCIAL, BASHKIA DEVOLL

2027-2030

Draft

25 qershor 2026

BASHKIA DEVOLL

Leave No One Behind

United Nations Development Programme
United Nations House
"Skenderbej" Street, Gurten Building, 2nd Floor, Tirana, Albania
Tel.: +355 (4) 2250 205, 2250 224, 2250 234

Përgatitja e Planit Social të Bashkisë Devoll u mundësua nga mbështetja e Programit "Leave No One Behind" i Kombeve të Bashkuara. Ky program është i angazhuar për të mbështetur reformën e shërbimeve të kujdesit shoqëror në Shqipëri në përgjigje të përpjekjeve të qeverisë shqiptare për të mundësuar përfshirjen sociale të grupeve në nevojë. Në bashkëpunim të ngushtë me qeverinë qendror programi LNB po mbështet Bashkitë për të zhvilluar, zbatuar dhe monitoruar Planet Sociale Lokale. Ligji nr. 121/2016 "Mbi shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" ngarkon Bashkitë me detyrën e përgatitjes së këtyre Planeve bazuar në nevojat e identifikuara për shërbime të kujdesit shoqëror në territorin e tyre.

Përmbajtja

Lista e tabelave dhe figurave 3

Shkurtesa 4

1.Hyrje 5

2. Vlerësimi I arritjeve të Planit Social, 2024-2027 6

3. Kuadri llogjik I Planit të Përkujdesit Social, 2027-2030 8

3.1. Baza legjislative 8

3.1 Vizioni 9

3.2 Misioni 10

3.3 Vlerat dhe parimet udhërrëfyese 10

3.3.1 Vlerat 10

3.3.2. Parimet udhëheqëse 10

3.3.3 Procesi i hartimit të Planit Social 2027-2030 11

3.3.4 Analiza SWOT 13

4. Analiza e situatës 14

4.1. Të dhëna demografike 14

4.2. Grupet e përjashtuara ose në rrezik përjashtimi 16

4.2.1. Përfituesit e Ndihmës ekonomike 16

4.2.2.Aftësia e kufizuar 17

4.2.3. Punëkërkuesit e papunë 19

4.2.4. Fëmijët e përjashtuar ose në rrezik përjashtimi 20

4.2.5. Gra në situatë kritike 20

4.2.6.Të moshuar në situatë kritike 21

4.2.7.Minoritetet etnike 22

4.2.8.Të pastrehë 23

4.2.9.Të mitur të huaj të pashoqëruar 23

4.3. Profili i shërbimeve që ofrohen në bashkinë Devoll.....24
4.3.1. Shërbimet dhe institucionet e përkujdesit shoqëror 24
4.3.2. Përfituesit e shërbimeve të përkujdesit shoqëror 25
4.3. 3 Burimet njerëzore, ofruese të shërbimeve të përkujdesit shoqëror. 26
4.4. Përmbledhje: Grupet e përjashtuara ose në rrezik përjashtimi 27
5. Vlerësimi cilësor I nevojës për shërbime të përkujdesit shoqëror 29
6. Fushat strategjike në të cilat duhet të ndërhyjë bashkia nëpërmjet Planit Social 2027-2030 33
6.1. Prioritetet, qëllimi dhe objektivat.....33
6.2.Kosto e përgjithshme e Planit të Shërbimeve Sociale, 2027-2030 34
7. Plani i veprimit.....35
8. Plani I Integruar I Monitorimit dhe Vlerësimit.....47
9. Vlerësimi i mundësisë së mbulimit të kostos së planit social nëpërmjet të Ardhurave të Veta të Bashkisë. .....**Error! Bookmark not defined.**
9.1.Baza ligjore për financimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror në nivel lokal. .....**Error! Bookmark not defined.**
9.2.Analizë e shpenzimeve të mbrojtjes shoqërore në bashkinë Devoll..... **Error! Bookmark not defined.**
8.3.Analiza e të ardhurave të bashkisë Devoll .....**Error! Bookmark not defined.**
8.4.Të ardhurat e pritshme nga Transferta e Pa kushtëzuar për vitin 2024..... **Error! Bookmark not defined.**
8.5.Vlerësimi i mundësive për financimin e Planit Social të bashkisë **Error! Bookmark not defined.**
8.6.Rekomandime për mirë planifikimin e shpenzimeve të kujdesit shoqëror në bashkinë Devoll.....**Error! Bookmark not defined.**
8.7.Konkluzione përfundimtare......**Error! Bookmark not defined.**
Shtojcë 1: Raporti I Vlerësimit të Planit Social 2020-2023.....48

Lista e tabelave dhe figurave

Tabela 1: Shpërndarja e popullsisë sipas vendbanimit mbështetur në të dhënat e Regjistrit të Gjëndjes Civile
Tabela 2: Popullsia sipas grupmoshave
Tabela 3: Individë përfitues të ndihmës ekonomike në raport me numrin e përgjithshëm të popullsisë si edhe me numrin e aplikantëve të NE, në përqindje
Tabela 4: Përfituesit e ndihmës ekonomike, sipas përbërjes.
Tabela 5: Individët me AK, sipas përbërjes dhe përfitimeve monetare.
Tabela 6: Të dhëna mbi punëkërkuesit e papunë, numër dhe përqindje
Tabela 7: Fëmijë në situatë kritike dhe në nevojë për mbrojtje.
Tabela 8: Numri i grave në situatë kritike
Tabela 9: Të moshuarit në situatë kritike.

Tabela 10: Romë dhe Egjiptianë në nevojë për mbrojtje.
Tabela 11: Të pastrehë në nevojë për mbrojtje
Tabela 12: Të mitur të huaj të pashoqëruar.
Tabela 13: Shërbimet e përkujdesit shoqëror
Tabela 14: Përfitues të shërbimeve të përkujdesit shoqëror
Tabela 15: Individë në situatë kritike dhe në nevojë për shërbime
Tabela 16: Përmbledhje e individëve në nevojë për shërbime të identifikuara në raport me numrin e popullsisë
Tabela 17: Grupet më të përjashtuara dhe nevojat më kritike të tyre.
Tabela 18: Shërbimet më të nevojshme në bashkinë Devoll.
Tabela 19. Individët në nevojë dhe tipet e shërbimeve të mundshme sipas shportës së shërbimeve

Figura 1: Shpërndarja e Popullsisë sipas njësive administrative të bashkisë në %
Figura 2: Popullsia sipas grup moshave
Figura 3: Përqindja e Individëve me AK sipas njësive administrative.
Figura 4: Shërbimet e përkujdesit shoqëror 2026/2023
Figura 5: Tregues jo të drejtëpëtdrejtë të nevojës për shërbime
Figura 6: Treguesi Përfitues/Staf, raport

Shkurtesa

AK Aftësia e kufizuar

LSMS Studimi mbi matjen e nivelit të jetesës

PAK Pagesa e aftësisë së kufizuar

PBA Plan Buxheti Afatmesëm

PK Pagesa e kujdestarisë

1.Hyrje

Bashkia Devoll ndodhet në juglindje të Shqipërisë, në kufi me Greqinë, dhe përfaqëson një nga zonat më të rëndësishme bujqësore të vendit. Ajo ka një sipërfaqe prej 453.27 km² dhe përbëhet nga pesë njësi administrative: Bilisht, Qendër Bilisht, Hoçisht, Progër dhe Miras. Sipas Censusit 2011, bashkia numëron 26,716 banorë, ndërsa Regjistri Civil regjistron 42,388 banorë. Territori karakterizohet nga fusha pjellore, kodra dhe male, ndërsa përshkohet nga lumi Devoll, i cili ka ndikuar historikisht në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të zonës.

Gjatë dekadave të fundit, Devolli ka përjetuar rënie të popullsisë dhe plakje demografike si pasojë e emigracionit të vazhdueshëm drejt qyteteve të mëdha dhe vendeve të huaja. Megjithatë, zona ruan tradita të forta familjare, kulturore dhe komunitare, si dhe një identitet të spikatur historik e patriotik.

Ekonomia e bashkisë mbështetet kryesisht në bujqësi dhe blegtori. Kultivimi i drithërave, perimeve, fasuleve, mollëve dhe aktivitetet blegtorale përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave për shumë familje, ndërsa dërgesat monetare nga jashtë vendit vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në ekonominë lokale. Pozicioni kufitar me Greqinë krijon mundësi për tregti ndërkufitare dhe punësim sezonal, ndërsa vitet e fundit janë ndërmarrë iniciativa për zhvillimin e agroturizmit, turizmit natyror dhe sipërmarrjeve të vogla. Sipas të dhënave të vitit 2023, rreth 15% e popullsisë jeton nën nivelin e varfërisë dhe rreth 6% e forcës aktive për punë është e papunë.

Devolli gjithashtu karakterizohet nga vlera të rëndësishme historike dhe arkeologjike. Veçanërisht e njohur është Shpella e Trenit, një nga vendndodhjet më të rëndësishme prehistorike në Shqipëri, ku janë zbuluar dëshmi të hershme të jetës njerëzore. Krahas saj, zona përmban monumente dhe gjurmë kulturore që dëshmojnë vazhdimësinë e vendbanimeve njerëzore ndër shekuj.

Bashkia disponon potencial të konsiderueshëm për zhvillimin e turizmit natyror, kulturor, arkeologjik dhe rural. Pasuritë e Prespës, Shpella e Trenit, peizazhet natyrore dhe traditat lokale përbëjnë një bazë të rëndësishme për krijimin e një oferte turistike të qëndrueshme dhe konkurruese. Megjithatë, zhvillimi i qëndrueshëm i Devollit kërkon investime në bujqësinë moderne, turizëm, infrastrukturë, shërbime sociale dhe programe për fuqizimin ekonomik të komunitetit lokal.

Bashkia përballet me sfida të rëndësishme sociale dhe ekonomike, si emigracioni, plakja e popullsisë, mundësitë e kufizuara të punësimit, veçanërisht për të rinjtë dhe gratë, si dhe prania e familjeve në nevojë dhe grupeve në rrezik përjashtimi.

Me qëllim sigurimin e shërbimeve cilësore të përkujdesit shoqëror për individët dhe grupet më në nevojë kritike, Bashkia Devoll prej vitit 2019 ka hartuar dhe zbatuar Planet e Kujdesit Social. Plani i Kujdesit Social, 2027-2030, i hartuar në bashkëpunim me UNDP dhe donatorë

të tjerë, në kuadrin e programit “Askush të mos mbetet pas 3”, pason dy planet e mëparshme, por nuk është përsëritje e çështjeve, objektivave dhe aktiviteteve. Procesi gjithëpërfshirës për hartimin e planit të ri social mbështetet në:

- ✓ Analizën e arritjeve të planit të mëparshëm si edhe në identifikimin e objektivave të parealizuara.
- ✓ Përcaktimin e shkaqeve dhe faktorëve që penguan arritjen e objektivave.
- ✓ Vlerësimin e mundësive për përfshirjen e objektivave të parealizuara në planin e ri.
- ✓ Vlerësimin e mundësive për përfshirjen e aktorëve të rinj, jo tradicionalë në organizimin, financimin, mbështetjen dhe sigurimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

Vlerësohet se rreth 3% e nevojës për shërbime plotësohet në bashkinë Devoll, ndërsa koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese është 4%[1]. Plani i shërbimeve sociale të Bashkisë Devoll, 2027-2030 mbështetet në ofrimin e një pakete shërbimesh për të gjitha kategoritë e grupeve në nevojë, si dhe në filozofinë e ndërtimit të partneritetit midis aktorëve të ndryshëm, si institucionet e qeverisjes vendore dhe rajonale, organizatat ndërkombëtare, kombëtare dhe ato vendore, si dhe biznesin vendor si një mbështetës potencial në fuqizimin e shërbimeve sociale.

2. Vlerësimi I arritjeve të Planit Social, 2024-2027

Me qëllim formulimin e objektivave strategjike të përshtatshme dhe efektive, ekipi I bashkisë Devoll, I ngarkuar me detyrën e hartmit të planit të Përkujdesit Social, vlerësoi shkallën e arritjes së objektivave të planit 2024-2027 nëpërmjet një metodologjie të përgatitur për këtë qëllim, të mbështetur në mbledhjen e informacioneve mbi bazën e një pyetësori individual si edhe dy formularëve shoqërues (shih Shtojcë 1). Në këtë vlerësim u përfshi stafi teknik dhe politik I bashkisë, stafi i institucioneve të përkujdesit social, stafi I institucioneve nën varësinë e Ministrisë së Shëndetsisë dhe Mbrojtjes Sociale si edhe grupe të tjera të interesit, bashkëpunëtorë të bashkisë.

Të dhënat u mblodhën gjatë periudhës gjysmës së dytë të muajit Maj 2026. Analiza e të dhënave tregoi se Qëllimi Strategjik i Planit 2024-2027 është realizuar në masën 70%, nëpërmjet përdorimit të rreth 33% të buxhetit të planifikuar, kryesisht për shkak të mungesës së burimeve financiare si nga burimet e brendshme, ashtu edhe nga burimet e jashtme si fondi social dhe projektet e organizatave ndërkombëtare. **Sigurimi i shërbimeve të kujdesit social në familje, kryesisht për “Individë me aftësi të kufizuar”, është arritja më e rëndësishme e planit ekzistues social, ndërsa sigurimi i shërbimeve në familje për të moshuar mbetet sfidë strategjike.**

Plani Social 2024-2027 përbëhej nga tre objektiva strategjike, të cilët janë realizuar përkatësisht në masën 80%, 50% dhe 70%.

[1] Hartëzimi i shërbimeve të kujdesit social, 2025, https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/2025-08/hartezimi_2025.pdf

Objektiv strategjik 1 “Zgjerimi dhe forcimi i sistemit ekzistues të integruar të shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashki, i aftë të sigurojë shërbime të mbrojtjes, përkujdesit, integrimit dhe përfshirjes për të gjitha grupet në nevojë, të identifikuara dhe vlerësuara si të tilla, në përputhje me standartet kombëtare të shërbimeve të përkujdesit shoqëror” përbëhej nga katër objektiva specifike, nga të cilët “Sigurimi i shërbimeve të përkujdesit shoqëror për gra në nevojë kritike si edhe grupe të tjera, nëpërmjet organizimit dhe sigurimit të shërbimeve të punësimit dhe vetëpunësimit, formimit profesional, sipërmarrjes dhe fuqizimit ekonomik” është realizuar pjesërisht, pikërisht për shkak të burimeve të kuafizuara financiare si edhe kapaciteteve profesionale.

Objektivi i dytë strategjik, “Deri në vitin 2027, të sigurojë rritjen e kapaciteteve të bashkisë për ndërtimin e një ambienti të përshtatshëm që mbështet dhe ndihmon individët dhe grupet në nevojë kritike për t’u integruar në shoqëri, duke ruajtur dinjitetin njerëzor, pavarësisht nga gjendja e tyre ekonomike, shoqërore, shëndetsore apo autonomia e tyre funksionale, nëpërmjet politikave vendore efektive, në përputhje të plotë me nevojat dhe mundësitë e bashkisë”, përbëhej nga tre objektiva specifike. Ndër këto tre objektiva, objektivi i parë, “Fuqizim të kapaciteteve të Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve si edhe të gjithë seksionit të shërbimeve sociale” nuk është realizuar sepse bashkia nuk arriti të siguronte kushtet e nevojshme për punësimin e specialistëve përkatës**. Arritje e veçantë e bashkisë konsiderohet krijimi i fondit social lokal (objektivi specifik 3), krejtësisht nga të ardhurat e bashkisë**.

Objektivi i tretë strategjik, “Ndërgjegjësimi i individëve dhe grupeve në nevojë për të marrë pjesë dhe kërkuar hartimin dhe zbatimin e politikave vendore efektive, që nxisin integrimin e tyre në shoqëri”, përbëhej gjithashtu nga tre objektiva specifike, nga të cilët objektivi i dytë “ Ndërgjegjësim të komuniteteve të qytetarëve për të drejtat e tyre si edhe mundësitë e realizimit” është realizuar plotësisht, ndërsa dy objektivat e tjera specifike janë realizuar pjesërisht.

Vlerësimi i shkallës të realizimit të secilit objektiv specifik dhe objektivave strategjike është ilustruar edhe nëpërmjet krahasimit të vlerave faktike të treguesve të monitorimit, me vlerat e planifikuara. Raporti i detajuar i vlerësimit të planit social 2023-2027 paraqitet në Shtojcën 2.
Faktorët themelorë pengues për realizimin e objektivave të formuluara konsiderohen:

- Trashëgimia thuajse inekzistente e shërbimeve të përkujdesit shoqëror
- Pamjaftueshmëria e kapaciteteve njerëzore dhe financiare.
- Niveli i pamjaftueshëm i kualifikimit.
- Mungesa e mbështetjes së bashkisë nga partnerët e saj.
- Mbështetja e pamjaftueshme e ekipit drejtues të bashkisë ndaj rritjes dhe zhvillimit të struktrave të shërbimeve sociale.

Analiza e shkallës së realizimit të planit të mëparshëm tregoi gjithashtu se institucionet dhe organizatat lokale kanë qenë të përfshira edhe në hartimin, edhe në zbatimin e planit të mëparshëm. Konkretisht, jo vetëm bashkia, niveli politik drejtues, niveli ekzekutiv drejtues dhe teknik, por edhe Drejtoria Rajonale e Shëndetsisë, Zyra e Punës, Zyra Rajonale e

Shërbimit Social, OJF dhe Shoqata në mbrojtje të të drejtave të grupeve të përjashtuara, janë përfshirë në mënyrë aktive dhe të ndërgjegjshme, në zbatimin e planit social. .

Për shkak të shkallës së lartë të përfshirjes të strukturave më thelbësore, Plani Social 2024-2027 ka patur ndikim në ndërgjegjësimin e pushtetit vendor në domosdoshmërinë e rritjes së vëmëndjes ndaj të drejtave sociale të grupeve të përjashtuara, të cilët gjithashtu janë më të ndërgjegjësuara në raport me të drejtat e tyre. Ata njohin funksionimin e strukturave të mbrojtjes sociale dhe kërkojnë shërbimet që kanë nevojë, paralelisht me njohjen dhe vlerësimin e mbështetjes së siguruar nga pushteti vendor.

Pavarësisht arritjeve, ekipi i bashkisë është përballuar me sfida kritike përgjatë rrugëtimit 3 vjeçar të zbatimit të Planit të Përkujdesit Social. Konkretisht, çështjet më kritike konsiderohen:

- Legjislacioni i cunguar, që nuk krijon hapësira për vetëveprim e inisiativa lokale;
- Indiferenca e strukturave të ministrive në nivel lokal;
- Papunësia;
- Varfëria;
- Buxhetet e kufizuara.

Përveç vlerësimit të shkallës së realizimit të objektivave, metodologjia e ndërtuar posaçërisht për këtë vlerësim, përbëhej edhe nga dy komponentë të tjerë, përkatësisht:

- Analiza dhe vlerësimi i nevojës për shërbime të përkujdesit shoqëror duke përdorur pyetsorin individual 2 si edhe formularin shoqërues 3 si instrumenta të kërkimit.
- Vlerësimi i kapaciteteve njerëzore dhe financiare për sigurimin e shërbimeve sipas nevojës, nëpërmjet mbledhjes të të dhënave duke përdorur formularin 4 si instrument kërkimi.

Pyetsori 2, formularët 3 dhe 4 gjithashtu paraqiten tek Shtojca 1.

Të gjitha përfundimet e sipërpërmendura janë përfshirë në hartimin e kuadrit llogjik të planit të ri social si edhe në përcaktimin e mënyrave, nëpërmjet të cilave do të trajtohen problemet më kritike në funksion të ndërtimit të shërbimeve efektive sociale për të garantuar të drejtat sociale të qytetarëve të bashkisë Devoll.

3. Kuadri llogjik I Planit të Përkujdesit Social, 2027-2030

3.1. Baza legjislative

Politikat vendore në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror mbështeten në kuadrin ligjor dhe strategjik kombëtar të mbrojtjes sociale, i cili synon garantimin e aksesit të barabartë në shërbime cilësore për të gjithë qytetarët, pa diskriminim për shkak të gjinisë, moshës, aftësisë së kufizuar, statusit social, etnisë, bindjeve fetare apo politike dhe karakteristikave të tjera individuale.

Dokumenti kryesor strategjik që orienton zhvillimin e sistemit të mbrojtjes sociale në Shqipëri është Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2024–2030, e miratuar me

Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 152, datë 13.03.2024. Strategjia synon garantimin e një jetese me dinjitet për çdo individ gjatë gjithë ciklit të jetës, reduktimin e varfërisë dhe përjashtimit social, fuqizimin e familjeve dhe individëve drejt vetëpërfshirjes ekonomike, si dhe zgjerimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të kujdesit shoqëror në të gjithë territorin e vendit.

Në veçanti, Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2024–2030 synon konsolidimin e sistemit të decentralizuar të shërbimeve sociale, zgjerimin e mbulimit gjeografik të shërbimeve komunitare, forcimin e mekanizmave të identifikimit dhe referimit të rasteve në nevojë, përmirësimin e financimit të qëndrueshëm të shërbimeve sociale dhe rritjen e koordinimit ndërmjet institucioneve qendrore dhe vendore.

Bazuar në Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024–2030, në Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", si dhe në Ligjin nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", bashkitë mbeten aktorët kryesorë për planifikimin, organizimin, financimin, ofrimin dhe monitorimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel vendor. Për këtë arsye, ato kanë përgjegjësinë për të vlerësuar nevojat sociale të komunitetit, për të hartuar dhe zbatuar plane sociale vendore dhe për të siguruar aksesin e grupeve vulnerabël në shërbime të përshtatshme dhe cilësore.

Në përputhje me nenin 24 të Ligjit nr. 139/2015, bashkitë ushtrojnë funksione në fushën e mbrojtjes sociale, duke përfshirë krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale për grupet në nevojë, ngritjen dhe administrimin e qendrave të shërbimeve sociale, si dhe krijimin dhe administrimin e Fondit Social në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse.

Hartimi i Planit Social Vendor është një detyrim ligjor që rrjedh nga neni 36 i Ligjit nr. 121/2016. Plani Social përbën instrumentin kryesor të planifikimit vendor për zhvillimin e shërbimeve sociale, duke u mbështetur në vlerësimin e nevojave të komunitetit, në paketën bazë të shërbimeve sociale dhe në prioritetet strategjike kombëtare e vendore.

Financimi i shërbimeve sociale realizohet përmes Fondit Social, i cili mbështetet nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit, fondet e njësive të vetëqeverisjes vendore, kontributet e donatorëve dhe burime të tjera të ligjshme financimi. Mekanizmat e financimit dhe metodologjia e përllogaritjes së fondeve rregullohen nga legjislacioni përkatës në fuqi, përfshirë VKM nr. 111/2018 "Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social" dhe VKM nr. 150/2022 "Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror".

Për garantimin e ofrimit efektiv të shërbimeve, bashkitë organizojnë strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale dhe Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, të cilat sigurojnë identifikimin, vlerësimin, referimin dhe ndjekjen e rasteve në nevojë, si dhe koordinimin e mbështetjes ndërmjet institucioneve dhe ofruesve të shërbimeve sociale.

Plani Social 2027-2030 hartohet në përputhje me prioritetet kombëtare të vendit dhe ato të bashkisë Devoll, në përputhje me nenet 70 dhe 99, të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, dokumentin e Partneritetit 2007 si pjesë thelbësore e kuadrit afatgjatë strategjik të Shqipërisë të përcaktuar nga Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian

(SKZHIE 2030), me qëllim përshpejtimin e procesit të integrimit evropian dhe përafrimin e politikave sociale me standardet e Bashkimit Evropian.

3.1 Vizioni

Mbrojtje sociale në një mjedis mundësues dhe fuqizues për çdo individ në nevojë në bashkinë Devoll, duke garantuar jetesë dinjitoze përgjatë ciklit të jetës.

3.2 Misioni

Nëpërmjet këtij plani, Bashkia Devoll do të garantojë shërbime të kujdesit shoqëror me cilësi të lartë në bashkëpunim me OJF-të dhe sektorin privat për të përmirësuar jetën e fëmijëve dhe të të rriturve, të përjashtuar dhe/ose në rrezik përjashtimi, duke siguruar mbrojtjen, përfshirjen dhe integrimin shoqëror të tyre.

3.3 Vlerat dhe parimet udhërrëfyese

3.3.1 Vlerat

Plani Social i Bashkisë Devoll përgjatë realizimit të misionit do të ndihmojë në:

- ✓ Rritjen e përgjegjësive të pushtetit lokal për të mundësuar, mbështetur, mbrojtur dhe garantuar realizimin e të drejtave sociale të qytetarëve të bashkisë Devoll, në radhë të parë, të atyre më të përjashtuar dhe në rrezik përjashtimi;
- ✓ Forcimin e kapaciteteve institucionale që ofrojnë shërbime të integruara dhe të veçanta për individë dhe grupe në nevojë kritike, si në komunitet ashtu dhe në familje;
- ✓ Sigurimin e bashkërendimit dhe bashkëpunimit midis qeverisë qendrore, pushtetit vendor dhe rrjetit të organizatave jofitimprurëse;
- ✓ Fuqizimin e institucioneve të pushtetit vendor, sidomos në drejtim të identifikimit të personave "në nevojë" ose "të rrezikuar" si dhe të vendimmarrjes mbështetur në parimin e interesit më të mirë të qytetarit dhe të respektimit të të drejtave sociale;
- ✓ Zbatimin e praktikave të mira dhe të modeleve të përparuara të financimit të shërbimeve sociale;
- ✓ Përdorimin me efektivitet të Fondit Social dhe përcaktimin e proceseve që garantojnë përdorimin e tij;
- ✓ Zgjerimin e rrjetit të bashkëpunëtorëve, në drejtim të përfshirjes dhe fuqizimit të bashkëpunimit me partnerë tradicionalë dhe jo tradicionale, duke synuar interesin më të mirë të qytetarit;
- ✓ Vëzhgimin/mbikqyrjen e zbatimit të standardeve të miratuara të shërbimeve sociale, pavarësisht nga format dhe tipologjitë e shërbimeve.

3.3.2. Parimet udhëheqëse

Hartimi i Planit Social të Bashkisë Devoll udhëhiqet nga parimet që vijojnë:

- ✓ Respektimi dhe garantimi i të drejtave për mbrojtje dhe siguri sociale në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga aktet ndërkombëtare dhe legjislacioni kombëtar;
- ✓ Nxitja e pjesëmarrjes të grupeve përfituese dhe grupeve të tjera të inetresit, përgjatë procesit të hartimit të planit si edhe të monitorimit të zbatimit të tij ;
- ✓ Fuqizimi në nivel personal dhe komunitar i individëve në nevojë, duke realizuar integrimin dhe përfshirjen e tyre në aktivitete ekonomike e sociale;

- ✓ Zbatimi i politikave lokale të mbështetura në parimet e mbrojtjes të inetresit më të mirë të fëmijës dhe të respektimit të barazisë gjinore ;
- ✓ Ndërtimi i politikave lokale në përputhje me kompetencat vendore që rrjedhin nga Ligji mbi Reformën Territoriale.
- ✓ Garantimi i aksesit të barabartë tek shërbimet e decentralizuara të shërbimeve shoqërore;
- ✓ Ofrimi i shërbimeve shoqërore të ndërtuara mbi parimin e de-institucionalizimit;
- ✓ Ndërtimi i shërbimeve të qëndrueshme nga pikëpamja financiare dhe kosto-efektive.
- ✓ Krijimin e Fondit Social për financimin e ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale.

3.3.3 Procesi i hartimit të Planit Social 2027-2030

Procesi i hartimit të Planit Social Vendor u konceptua si një proces gjithëpërfshirës dhe kompleks, i cili ndërthur disa komponentë metodologjikë dhe analitikë, me qëllim sigurimin e një analize të plotë të situatës sociale dhe planifikimin e ndërhyrjeve për periudhën 2027–2030. Ky proces u mbështet në disa elementë kryesorë:

1. Analiza e zbatimit të Planit ekzistues (2023–2026).

U realizua një analizë e thelluar e arritjeve dhe sfidave të Planit ekzistues përmes vlerësimit të aktiviteteve të realizuara, objektivave specifike dhe qëllimit strategjik, si dhe analizës së buxheteve të shpenzuara sipas objektivave dhe treguesve të monitorimit (instrumentet e vlerësimit paraqiten në Shtojcën 1).

Instrumenti thelbësor, Pyetësori 1, përbëhet nga një listë e strukturuar pyetjesh, e administruar përmes intervistave ballë për ballë me zyrtarët kryesorë të bashkisë dhe ofruesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror që veprojnë në territorin e saj. Qëllimi i këtyre intervistave është mbledhja e evidencave mbi nivelin e zbatimit dhe arritjes së objektivave të Planit Vendor të Kujdesit Shoqëror, identifikimi i sfidave dhe pengesave kryesore, si dhe vlerësimi i progresit në raport me treguesit e monitorimit. Për të plotësuar analizën, u përdorën gjithashtu Formulari 1 dhe 2. Formulari 1 dokumenton aktivitetet e realizuara në raport me ato të planifikuara për çdo objektiv specifik, duke pasqyruar nivelin e zbatimit dhe progresin e arritur, ndërsa Formulari 2 regjistron shpenzimet faktike në raport me fondet e planifikuara, duke mundësuar analizën e performancës financiare dhe përputhshmërisë së burimeve të planifikuara dhe atyre të përdorura.

2. Analiza shumëdimensionale e nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror.

Instrumentet e analizës paraqiten në Shtojcën 1. Instrumenti kryesor, Pyetësori 2, përbëhet nga një listë e strukturuar pyetjesh, e administruar përmes intervistave me të gjithë ofruesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror që veprojnë në territorin e bashkisë. Qëllimi i këtyre intervistave është mbledhja e evidencave për vlerësimin e nevojave prioritare të grupeve në nevojë, vulnerabël dhe të përjashtuara socialisht. Bazuar në analizën e të dhënave të mbledhura përmes Pyetësorit 2, u identifikuan prioritetet kryesore për periudhën 2027–2030. Formulari 3, i përdorur në mbështetje të Pyetësorit 2, përmbledh të dhëna statistikore mbi grupet e përjashtuara, të ndara sipas moshës, gjinisë dhe statusit socio-ekonomik.

3. Vlerësimi i kapaciteteve njerëzore, institucionale dhe financiare.

Instrumentet e analizës paraqiten në Shtojcën 1. Ky komponent fokusohet në vlerësimin e kapaciteteve njerëzore, financiare dhe institucionale të nevojshme për zbatimin efektiv të Planit Social Vendor. Evidencat u mblodhën nga burime dytësore përmes Formularit 4 dhe Formularit 5. Formulari 4 pasqyron shpenzimet për mbrojtjen sociale dhe shërbimet e kujdesit shoqëror gjatë pesë viteve të fundit, si dhe shpenzimet e planifikuara në kuadër të Planit Buxhetor Afatmesëm (PBA). Formulari 5 ofron një pasqyrë të kapaciteteve ekzistuese njerëzore dhe institucionale të angazhuara në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashki. -

4. Analiza gjithëpërfshirëse dhe përcaktimi i prioriteteve.

Realizimi I analizës të integruar të të dhënave nga burimet parësore dhe dytësore, mundësoi formulimin e prioriteteve për periudhën 2027–2030, përmes kombinimit të analizës sasiore dhe cilësore të nevojave dhe drejtimeve të ndërhyrjes.

5. Forcimi i kapaciteteve institucionale.

U realizuan tre takime/seminare me pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve, me qëllim rritjen e kapaciteteve të bashkisë për hartimin e planeve strategjike afatmesme (evidencat paraqiten në Shtojcën 2).

Plani Social i Bashkisë Devoll, I hartuar nëpërmjet procesit gjithëpërfshirës dhe kompleks, trajton nevojat dhe sfidat sociale të qytetarëve, përfshirë varfërinë, papunësinë, mungesën e aksesit në shërbimet shëndetësore dhe arsimore, si dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe të rriturve. Plani ofron një vizion të qartë dhe të strukturuar për përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve përmes politikave dhe masave gjithëpërfshirëse sociale. Zbatimi i suksesshëm i Planit Social Vendor kontribuon në përmirësimin e infrastrukturës sociale, rritjen e aksesit në shërbimet thelbësore dhe krijimin e mundësive për një jetë më të mirë dhe më të qëndrueshme për të gjithë qytetarët.

Bashkia Devoll e ndërmori hartimin e këtij Plani jo vetëm për të përmbushur detyrimet ligjore, por edhe për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe për të garantuar mbështetje për qytetarët në nevojë. Plani nuk përfaqëson thjesht një dokument administrativ, por një instrument strategjik për koordinimin e shërbimeve sociale dhe për sigurimin që asnjë individ të mos mbetet pas. Nëpërmjet këtij Plani, bashkia ndërton një qasje strategjike për reduktimin e varfërisë, përjashtimit social dhe diskriminimit, duke promovuar barazinë dhe adresuar nevojat specifike të grupeve të ndryshme.

Transparenca në procesin vendimmarrës rrit besueshmërinë dhe hapjen ndaj qytetarëve, duke forcuar përgjegjshmërinë sociale dhe ligjore. Hartimi i Planit Social Vendor është në përputhje me kuadrin ligjor dhe strategjik në fuqi në Republikën e Shqipërisë, përfshirë Kushtetutën, konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara, Kartën Sociale Evropiane (të rishikuar), Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore, standardet e OBSH-së, Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024–2030, Ligjin nr. 139/2015 “Për

Vetëqeverisjen Vendore" dhe Ligjin nr. 121/2016 "Për Shërbimin e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë". Këto akte përcaktojnë detyrimet e bashkive për identifikimin e nevojave, planifikimin e burimeve dhe ofrimin e shërbimeve të koordinuara sociale.

Procesi për hartimin e Planit Social kaloi në gjashtë faza kryesore:
Faza 1 – Vendimmarrja politike dhe teknike. Gjatë muajve mars–prill 2026, Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, morën vendimin për hartimin e Planit Social Vendor 2027–2030.

Faza 2 – Mbledhja e të dhënave . Gjatë periudhës 22 maj – 15 qershor u mblodhën të gjitha të dhënat e nevojshme për analizën e situatës sociale.

Faza 3 – Analiza dhe prioritarizimi. Të dhënat u analizuan për të identifikuar tendencat, nevojat dhe sfidat kryesore që duhet të trajtohen në plan.

Faza 4 – Hartimi i draft-Planit. U hartua drafti i Planit Social Vendor, duke përcaktuar objektivat, strategjitë dhe veprimet konkrete. Drafti u finalizua më 25 qershor dhe u shpërnda për komente dhe rekomandime tek të gjithë aktorët përkatës.

Faza 5 – Konsultimi publik dhe miratimi. Drafti i rishikuar u hodh për konsultim publik më 9 korrik dhe, pas reflektimit të komenteve, u dorëzua për miratim më 30 korrik 2026.

Faza 6 – Zbatimi. Zbatimi i Planit varet në mënyrë kritike nga sigurimi i burimeve financiare, përtej fondeve të bashkisë.

Kapitulli 9 i Planit paraqet analizën e detajuar të kostove dhe burimeve financiare të mundshme. Mobilizimi i burimeve shtesë përmes Fondit Social, programeve kombëtare, donatorëve dhe instrumenteve të tjera financiare mbetet një kusht thelbësor për realizimin e objektivave të Planit.

Në përfundim të analizave dhe diskutimeve u identifikuan prioritetet thelbësore për periudhën 2027-2030, në mbështetje të të cilave u formuluan qëllimi dhe objektivat strategjike, të cilat paraqiten tek Kapitulli 6.1.

3.3.4 Analiza SWOT

Fuqi:

- ✓ Kërkesa për shërbime sociale është çështje emergjente.
- ✓ Bashkia Devoll, ndonëse bashki e re, është e motivuar dhe e paisur me kapacitete njerëzore, teknike dhe profesionale, të përshtatshme për të ndërtuar dhe administruar shërbime cilësore sociale.
- ✓ Rritja e eksperiencës së stafit, eksperiencë e fituar kryesisht gjatë zbatimit të planeve të mëparshme sociale.

Dobësi:

- ✓ Varfëria, zhvillimi modest i biznesit dhe tregut të punës.
- ✓ Prezenca e vogël e organizatave jo fitim-prurëse në territorin e Bashkisë.

- ✓ Ekspertizë e pamjaftueshme lokale në drejtim të ofrimit të shërbimeve, administrimit dhe monitorimit të tyre.
- ✓ Pavarësisht decentralizimit, lidhja dhe bashkëpunimi me Shërbimin Social Shtetëror, realizohet nëpërmjet qarkut Korçë, jo drejtpërsëdrejti.

Mundësi:

- ✓ Reforma e Qeverisjes Vendore.
- ✓ Decentralizimi i shërbimi i sociale.
- ✓ Rritja e kompetencave të qeverisjes vendore dhe rritja e përpjekjeve për ndërgjegjësimin e tyre.
- ✓ Krijimi dhe forcimi i Fondit Social dhe atij lokal
- ✓ Rritja e mundësive për aplikim për financime nga donatorët për shërbimet sociale.
- ✓ Vlerësimi me përparësi i zhvillimit të sistemit të shërbimeve sociale, nga qeveria.

Kufizime

- ✓ Mundësi të kufizuara të pjesëmarrjes të sektorit privat dhe sektorit jo fitim-prurës në mbështetjen e shërbimeve sociale në Devoll.

4. Analiza e situatës

4.1. Të dhëna demografike

Të dhënat demografike janë të rëndësishme jo vetëm për të vlerësuar madhësinë e grupeve në nevojë për shërbime në raport me popullsinë e Bashkisë Devoll, por edhe për të vlerësuar burimet njerëzore që duhet të ketë Bashkia në dy nivelet e organizimit (Bashki dhe njësi administrative) si detyrim që rrjedh nga legjislacioni kombëtar.

Sipas regjistrit të gjendjes civile, popullsia e bashkisë Devoll, në territorin e riorganizuar në përputhje me Ligjin nr. 139/2015, është 40.303 banorë(Tabela 1).

Tabela nr.1: Shpërndarja e popullsisë sipas vendbanimit mbështetur në të dhënat e Regjistrit të Gjëndjes Civile

Njësia Administrative	Numri i Popullsisë	Vendbanimi (persona)		Gjinia	
		Urban	Rural	Femra	Meshkuj
Qendër Bilisht	8.314		8.314	4.082	4.232
Miras	9.380		9.380	4.518	4.862
Hoçisht	6.549		6.549	3.238	3.311
Progër	5.678		5.678	2.806	2.872
Bilisht	10.382	10.382		5.243	5.139
Gjithsej	**40.303**	**10.382**	**29.921**	**19.887**	**20.416**

Burimi: Bashkia Devoll, Maj 2026.


Duke ju referuar treguesve të tjerë demografikë, konstatohet se:

- ✓ Bashkia Devoll është kryesisht rurale, meqenëse 70% e popullsisë jeton në zonën rurale, ndërsa 30% e popullsisë jeton në zonën urbane.

- ✓ Shpërndarja sipas gjinisë është thuajse e barabartë, me një përparësi të lehtë të gjinisë mashkullore (51%).

Figura 1 dëshmon se 25% e popullsisë jeton në qytetin e Bilishtit, ndërsa 75% në katër njësitë e tjera administrative që përbëjnë bashkinë (Figura 1).


Figura 1: Shpërndarja e Popullsisë sipas njësive administrative të bashkisë në %



Burimi: Bashkia Devoll, Maj 2026.

Grup mosha 25 deri 65 vjeç përbën grupin më të konsiderueshëm (54%), por në krahasim me 5 vite më parë, përqindja e kësaj grup moshe ka rënie për shkak të lëvizjeve të fuqishme migratore. Grup mosha 0 deri 24 vjeç përbën 29% të popullsisë, tregues tepër domethënës për zhvillimin e forcave prodhuese dhe të punësimit. (Tabela 2 dhe Figura 2).

Figura 2: Popullsia sipas grupmoshave



Burimi: Bashkia Devoll, Maj 2026.

Tabela 2: Popullsia sipas grupmoshave

Njësia Administrative	Popullsia	Popullsia sipas grupmoshave					
		0-24 vjeç		25-65 vjeç		Mbi 65 vjeç	
		Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
Qendër Bilisht	8.314	1.937	956	4.725	2.289	1.396	715
Miras	9.380	2.223	1.064	5.299	2.564	1.585	759
Hoçisht	6.549	1.529	770	3.672	1.791	1.148	584
Progër	5.678	1.330	654	3.133	1.520	1.046	547
Bilisht	10.382	2.463	1.215	6.013	3.070	1.634	827
Gjithsej	**40.303**	**9.482**	**4.691**	**22.772**	**11.234**	**6.809**	**3.432**

Burimi: Bashkia Devoll, Maj 2026.

4.2. Grupet e përjashtuara ose në rrezik përjashtimi

4.2.1. Përfituesit e Ndihmës ekonomike

Informacionet dhe diskutimet me punonjësit e bashkisë, përgjegjës për shërbimet e përkujdesit shoqëror konfirmojnë se varfëria, mungesa e të ardhurave ose pamjaftueshmëria e tyre, janë shkaku themelor i përjashtimit shoqëror të familjes dhe individëve të saj. Në bashkinë e Devollit përfitojnë ndihmë ekonomike 801 familje ose 2.703 individë, 94% e aplikantëve që përbën 7% të popullsisë.

Tabela 3 ilustron përqindjen e përfituesve të ndihmës ekonomike në raport me popullsinë e bashkisë dhe të secilës njësi administrative. Siç vërehet, përfituesit e ndihmës ekonomike përbëjnë 7% të popullsisë së bashkisë, përkatësisht 3% të popullsisë në qytetin e Bilishtit (përqindja më e ulët), ndërsa 8.7% në Hoçisht (përqindja më e lartë). Siç mund të konfirmohet lehtësisht, përqindja e përfituesve të ndihmës ekonomike në krahasim me popullsinë është relativisht e ulët, ndërsa 94% e aplikantëve mbështeten ekonomikisht. Në krahasim me të njëjtën analizë të tre viteve më parë, numri i familjeve dhe individëve përfitues është ulur nga 9 në 7%. Por, në grupin e përfituesve të NE, gratë kanë peshë më të lartë në të gjitha njësitë administrative, me përjashtim të Hoçishtit dhe Bilishtit ku % e përfituesve femra në raport me popullsinë është e njëjtë me % e përfituesve meshkuj.

Faktorët që kushtëzojnë shkallën e ulët të mbështetjes me ndihmë ekonomike janë të ndryshëm. Shpjegimi më i dëshirueshëm lidhet me zhvillimin e vetëpunësimit në bujqësi dhe blegtori si edhe zhvillimin e turizmit, për shkak të pozicionit të përshtatshëm gjeografik si edhe kushteve klimaterike. Megjithatë, është e nevojshme që të hulumtohet më me kujdes situata ekonomike dhe sociale e popullsisë së Devollit si edhe të bëhen përpjekje për të llogaritur minimumin jetik të zonës.

Tabela 3: Individë përfitues të ndihmës ekonomike, numër dhe përqindje.

Njësia Administrative	Populsia		Aplikantë NE Familje	Përfitues NE Familje	% Përfitues/ Aplikues	Individë përfitues NE		% Përfitues NE/ Populsi	
	Gj	F	Gjithsej	Gjithsej		Gj	F	Gj	F
Qendër Bilisht	8.314	4.082	196	183	93	600	308	7	7.5
Miras	9.380	4.518	272	256	94	849	457	9	10
Hoçisht	6.549	3.238	174	160	92	575	281	8.7	8.7
Progër	5.678	2.806	123	116	94	407	217	7.2	7.7
Bilisht	10.382	5.243	92	86	94	272	141	3	3
Gjithsej	**40.303**	**19.887**	**857**	**801**	**94**	**2.703**	**1.404**	**7**	**7**

Burimi: Bashkia Devoll, Maj 2026.

Tabela 4 ilustron përbërjen e përfituesve të ndihmës ekonomike. Vërehet se "fëmijë deri 16 vjeç" përbëjnë 29% të përfituesve të ndihmës ekonomike, Individët me AK, 3%, Gratë kryefamiliare 5%, Të moshuarit, 14% dhe Fëmijë me AK 0,4%.

Tabela 4: Përfituesit e ndihmës ekonomike, sipas përbërjes.

Njësia Administrative	Individë Përfitues		Fëmijë deri 16 vjeç		Të moshuar		Gra Kryefa miliare	Individö AK	Fëmijë AK
	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj		
Qendër Bilisht	600	308	173	92	66	24	35	18	2
Miras	849	457	243	145	143	74	36	26	4
Hoçisht	575	281	157	89	87	22	23	15	2
Progër	407	217	106	62	52	18	17	14	3
Bilisht	272	141	95	58	28	12	15	10	1
Gjithsej	**2.703**	**1.404**	**774**	**446**	**376**	**150**	**126**	**83**	**12**
Në përqindje			29		14		5	3	0.4

Burimi: Bashkia Devoll, Maj 2026.

Analiza tregon se varfëria, duke gjykuar nga përqindja e familjeve përfituese të NE, është fenomen kryesisht "rural". Fëmijët zënë një peshë të konsiderueshme në numrin e përgjithshëm të anëtarëve të familjeve përfituese të NE, gjë e cila duhet të konsiderohet në hartimin e politikave lokale të mbështetjes nëpërmjet NE ose formave të tjera të shërbimeve sociale. Të moshuarit gjithashtu përbëjnë një përqindje të konsiderueshme në numrin e prëgjithshëm të familjeve përfituese të NE.

Familjet përfituese të NE kanë në përbërje të tyre individë të moshuar, gjë e cila e vështirëson situatën sociale dhe ekonomike të familjes, sidomos në raport me tregun e punës, duke zvogëluar mundësitë e punësimit, përfshirjes dhe integrimit të familjes. Megjithatë, familjet përfituese të NE, në përbërjen e të cilave ka anëtarë me AK ose mbajtësi është grua, zënë një peshë relativisht të ulët.

4.2.2.Aftësia e kufizuar

3% e popullsisë në Bashkinë Devoll (referuar të dhënave të bashkisë, Tabela 5) është me aftësi të kufizuar ose invaliditet pune. 55% e tyre përfitojnë nga programi i pagesave monetare të aftësisë së kufizuar të financuar nga buxheti kombëtar. Nga 1,071 persona me AK dhe invaliditet, 3% janë fëmijë dhe 26 % janë të moshuar.

11% e personave me aftësi të kufizuar, 51% e fëmijëve me AK dhe 12% e të moshuarve me AK, kanë një formë shumë të rëndë të aftësisë së kufizuar e për rrjedhojë kanë të drejtën e një kujdestari/ndihmësi me pagesë që kujdeset për ta.

Tabela 5: Individët me AK, sipas përbërjes dhe përfitimeve monetare.


Njësia Administrative	Individë AK				Fëmijë AK				Të moshuar AK		Invalidë pune		Përfitojnë PAK	
	Përfitojnë PAK,		Përfitojnë pagesë Kujdestarie		Përfitojnë PAK		Përfitojnë pagesë kujdestarie							
	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F
Qendër Bilisht	150	74	45	35	14	6	7	7	20	9	120	71	7	3
Miras	153	78	31	20	10	5	4	3	25	9	155	86	16	9
Hoçisht	95	43	19	13	7	0	4	4	6	3	92	45	16	6
Progër	84	44	19	13	3	1	2	1	5	3	85	40	8	1
Bilisht	111	46	28	19	12	5	6	5	17	8	183	99	3	1
GJITHSEJ	**593**	**285**	**142**	**100**	**46**	**17**	**23**	**20**	**73**	**32**	**635**	**341**	**50**	**20**

Burimi: Bashkia Devoll, Maj 2026.

Mëse 28% e personave me aftësi të kufizuara banojnë në njësinë administrative Hoçisht, 26% e tyre banojnë në njësinë adminsitrative Qendër Bilisht, nga 17% në Miras dhe Progër, ndërsa 12% banojnë në Bilisht. (figura 3).

Aftësia e kufizuar është një nga faktorët më kritikë të përjashtimit shoqëror. Në Bashkinë Devoll, personat me aftësi të kufizuar përjetojnë përjashtim të shumfishtë sepse përveç aftësisë së kufizuar, janë të përjashtuar nga tregu i punës si edhe nga mundësia për të siguruar një nivel të pranueshëm jetese.

Figura 3: Përqindja e Individëve me AK sipas njësive administrative



Burimi: Bashkia Devoll, Maj 2026

4.2.3. Punëkërkuesit e papunë

Janë gjithsej 758 punëkërkues të papunë në Bashkinë Devoll. Papunësia në Devoll ka profil krejtësisht urban dhe femëror. Vihet re se gratë përbëjnë mëse 80% të të papunëve të regjistruar, nga të cilat 5% janë kryefamiliare. Të rinjtë deri 25 vjeç përbëjnë 18%, ndërsa gratë mbi 25 vjeç përbëjnë grupin më të madh, 45%. 7% e të papunëve përfitojnë pagesë papunësie, ndërsa vetëm 5% e të papunëve përfitojnë nga programet e formimit profesional. (tabela 6).

Tabela 6: Të dhëna mbi punëkërkuesit e papunë, numër dhe përqindje

Sipas statusit	**Nr. i individëve**	**Sipas gjinisë**		**% ndaj punëkërkuesve të papunë**
		Femra	Meshkuj	
Përfitojnë pagesë papunësie	50	38	12	7%
Përfitojnë nga PFP	36	22	14	5%
Romë/ Egjiptianë	154	81	73	20%
Emigratë të kthyer	0	0	0	
Gra mbi 25 vjeç, jo kryefamiljare	342	342	0	45%
Gra kryefamiljare	40	40	0	5%
Të rinj deri 25 vjeç	136	84	52	18%

Gjithsej	**758**	**607**	**151**	
Në %	**100**	**80**	**20**	**100**

Burimi: Bashkia Devoll, Maj 2026

4.2.4. Fëmijët e përjashtuar ose në rrezik përjashtimi

9% e fëmijëve janë të përjashtuar os enë rrezik përjashtimi për shkak të varfërisë së familjeve, aftësisë së kufizuar, keqtrajtimit, abuzimit ose braktisjes. Ndër fëmijët në nevojë kritike për mbrojtje, vajzat përbëjnë pjesën më të madhe.

Shkaku kryesor i përjashtimit të fëmijëve është varfëria e familjes. 91% e fëmijëve në nevojë e përbëjnë fëmijët e familjeve në NE, 5.4% fëmijët me AK, 3.6% fëmijët e dhunuar dhe 0.3% fëmijët e braktisur. (tabela 7).

Tabela 7: Fëmijë në situatë kritike dhe në nevojë për mbrojtje.

Njësia administrative	**Fëmijë gjithsej**		**Fëmijë në familje me NE**		**Fëmijë me AK gjithsej**		**Fëmijë të dhunuar**		**Fëmijë të braktisur**		**Fëmijë gjithsej në nevojë**	
	Gj	**F**	**Gj**	**F**	**Gj**	**F**	**Gj**	**F**	**Gj**	**F**	**Gj**	**F**
Qendër Bilisht	1.937	956	173	92	14	6	5	3			192	101
Miras	2.223	1.064	243	145	10	5	6	5			259	155
Hoçisht	1.529	770	157	89	7	0	7	4			171	93
Progër	1.330	654	106	62	3	1	2	1	2	1	113	65
Bilisht	2.463	1.215	95	58	12	5	11	9	1		119	72
Gjithsej	**9.482**	**4.691**	**774**	**446**	**46**	**17**	**31**	**22**	**3**	**1**	**854**	**486**
Në %			**91**	**91**	**5.4**	**3.5**	**3.6**	**4.5**	**0.3**	**0.2**	**100**	**100**
Në %	**100**	**100**									**9**	**10**

Burimi: Bashkia Devoll, Maj 2026

4.2.5. Gra në situatë kritike

Me qëllim evidentimin e kategorive të grave më të përjashtuara si edhe arsyet e përjashtimit, është ndërtuar Tabela 8, e cila paraqit informacion sasior të përmbledhur, mbi numrin e grave kryefamiliare në familjet përfituese të NE, numrin e grame me aftësi të kufizuar, numrin e grave viktima të dhunës në familje si edhe numrin e punëkërkueseve gra. Numri i punëkërkueseve gra për efekt të ndërtimit të tabelës 8 dhe të eleminimit të rrezikut të paraqitjes së informacionit artificialisht të rritur, është llogaritur si diferencë e numrit të punëkërkueseve të paraqitur në tabelën 6 me numrin e grave kryefamiliare, përfituese të NE të tabelës 4, sepse gratë kryefamiliare, përfituese të NE janë të papuna.

Tabela 8 dëshmon se4% e grave në bashkinë Devoll përjetojnë situatë kritike përjashtimi për shkak të pamjaftueshmërisë të të ardhurave ose arsyeve të tjera.

Tabela 8: Numri i grave në situatë kritike

Njësia administrative	Gra gjithsej	Gra kryefamiliare Përfituese NE	Gra të shfrytëzuara /të dhunuara	Punë kërkuese të papuna	Gra me AK	Gra të tjera në nevojë	Gjithsej	Në %
Qendër Bilisht	4.082	35	1	56	74	6	172	4%
Miras	4.518	36	3	59	78	5	181	4%
Hoçisht	3.238	23	0	61	43		127	3.9%
Progër	2.806	17	1	38	44	1	101	3.6%
Bilisht	5.243	15	1	128	46	7	197	3.7%
Gjithsej	**19.887**	**126**	**6**	**342**	**285**	**19**	**778**	**4%**

Burimi: Bashkia Devoll, Maj 2026.

4.2.6.Të moshuar në situatë kritike

Analiza e situatës të të moshuarve konsideron tregues kompleksë shëndetsorë, sociale dhe ekonomikë.

Tabela 9 paraqit përqindjen e të moshuarve në nevojë për shërbime sipas treguesve kompleksë të shpjeguar më lart. Sipas të dhënave të tabelës 9, mungesa e pensionit, karakteristikë për të moshuarit e zonës rurale, është faktori kryesor me natyrë monetare, I përjashtimit të të moshuarve. Siç vërehet, rreth 11% e të moshuarve jetojnë në kushte kritike.

Tabela 9 gjithashtu tregon se situata e të moshuarve është jashtëzakonisht kritike në njësinë Miras, ku 19% e të moshuarve janë në nevojë për mbrojtje dhe shërbime, pasuar nga të moshuarit e njësisë Hoçisht. Të moshuarit në nevojë për mbrojtje në njësinë Miras përbëjnë 41% të të gjithë të moshuarve në nevojë për mbrojtje të bashkisë Devoll. Edhe më kritike është situata e grave të moshuara në nevojë për mbrojtje në Miras, të cilat përbëjnë 49% të të gjitha grave të moshuara në nevojë për mbrojtje në bashkinë Devoll.

Tabela 9: Të moshuarit në situatë kritike.

Treguesit/Njësitë Administrative	Qendër Bilisht	Miras	Hoçisht	Progër	Bilisht	Gjithsej
Popullsia mbi 65 vjeç	1.396	1.585	1.148	1.046	1.634	6.809
Femra	715	759	584	547	827	3.432
Nuk përfitojnë Pension	2	8	6	2	3	21
Femra	1	3	2	1	1	8
Në familje NE	66	143	87	52	28	376
Femra	24	74	22	18	12	150
AK	20	25	6	5	17	73
Femra	9	9	3	3	8	32
Në situatë kritike	18	88	21	13	10	150

Femra	13	52	12	7	4	88
Të braktisur	6	18	9	3	4	40
Femra	3	8	2	1	1	15
Pa strehë	3	6	7	2	3	21
Femra	1	1	2	1	1	6
Kanë nevojë për kujdes në familje	8	16	8	3	25	60
Femra	2	8	2	1	3	16
Të moshuar në nevojë për mbrojtje						
Gjithsej	123	304	144	80	90	741
Femra	53	155	45	32	30	315
Në % ndaj popullsisë së moshuar	**9**	**19**	**12**	**8**	**5.5**	**11**
Në % Femra ndaj popullsisë së moshuar	**7**	**20**	**8**	**6**	**4**	**9**
Në % ndaj totalit të të moshuarve në nevojë për mbrojtje	**17**	**41**	**19**	**11**	**12**	**100**
Femra në % ndaj totalit të të moshuarave në nevojë për mbrojtje	**16**	**49**	**14**	**10**	**10**	**100**

Burimi: Zyra për Shërbimet Shoqërore, Bashkia Devoll, Maj 2026.

4.2.7.Minoritetet etnike

Komunitetet etnike Romë dhe Egjyptianë janë mjaft të kufizuar në numër në bashkinë Devoll. Ato përbëjnë rreth 1% të popullsisë. Tabela 10 sjell informacion mbi numrin e individëve të këtij komuniteti në nevojë për mbrojtje, pavarësisht peshës së ulët në popullsinë e përgjithshme të bashkisë.

Tabela 10: Romë dhe Egjiptianë në nevojë për mbrojtje.

Njësia administrative	**Romë dhe Egjiptianë**		**Të papunë**		**Të sëmurë ose AK**		**Pa strehë**		**Të tjerë në nevojë për mbrojtje dhe shërbime**		**Gjithsej**	
	Gj	**F**	**Gj**	**F**	**Gj**	**F**	**Gj**	**F**	**Gj**	**F**	**Gj**	**F**
Qendër Bilisht	35	20			3	1	1	1				
Miras	0	0					0	0				
Hoçisht	0	0					0	0				
Progër	53	23			2	1	0	0				
Bilisht	310	177	154	81	7	3	19	19	17	17		
Gjithsej	**398**	**220**	**154**	**81**	**12**	**5**	**20**	**20**	**17**	**17**	**203**	**123**

Në %											**51**	**56**

Burimi: bashkia Devoll, Maj 2026

4.2.8.Të pastrehë

Sipas informacioneve të Bashkisë Devoll, në territorin e kësaj bashkie familjet e pastreha nuk përbëjnë një përqindje kritike, vetëm 0,5%. Konkretisht, 130 familje rezultojnë të pastreha dhe pa të ardhura, nga të cilat më shumë se 50% jetojnë në njësinë Bilisht, zonë urbane.

Tabela 11: Të pastrehë në nevojë për mbrojtje

Njësia administrative	**Të pastrehë**		**Të pa strehë dhe pa të ardhura**	
	Gj	**F**	**Gj**	**F**
Qendër Bilisht	15	8	15	8
Miras	20	17	20	17
Hoçisht	10	7	10	7
Progër	5	4	5	4
Bilisht	80	55	80	55
Gjithsej	130	91	130	91

4.2.9.Të mitur të huaj të pashoqëruar

Gjatë tre viteve të fundit, Bashkia Devoll ka trajtuar të mitur të pashoqëruar, të cilëve iu janë siguruar shërbimet jetike, siç ilustrohet në tabelën 12.

Tabela 12: Të mitur të huaj të pashoqëruar.

Treguesit/Viti	**2024**	**2025**	**2026**
Të mitur të pashoqëruar	59	55	3
Femra	1	0	0
Nevojë për:			
Mbështetje me ushqim dhe veshmbathje	59	55	3
Strehim.	59	55	3
Arsim	0	0	0
Kujdes shëndetsor	10	7	1
Mbrojtje ligjore	59	55	3
Transport për në qendrat pritëse.	59	55	3

Mbështetje me punonjes social PMF nga Bashkia Devoll.	59	55	3

Burimi: Bashkia Devoll, Maj 2026

4.3. Profili i shërbimeve që ofrohen në bashkinë Devoll

4.3.1. Shërbimet dhe institucionet e përkujdesit shoqëror


Në bashkinë Devoll funksionojnë dy shërbime të përkujdesit shoqëror, përkatësisht Qendra shumë funksionale komunitare dhe Qendra ditore për të moshuarit. Të dyja financohen nga bashkia, por Qendra ditore financohet nga bashkia nëpërmjet fondit social (tabela 13).

Tabela 13. Shërbimet e përkujdesit shoqëror

Shërbimi social	**Qendra shumë funksionale**		**Qendra ditore**	
Zona e mbulimit	Bashkia		Bashkia	
Modeli organizimit	Publik		Publik	
Tipologjia	Rezidenciale		Ditore	
Burimi financimit	**Bashkia**		**Bashkia dhe fondi social**	
	Përfitues			
	Gjithsej	**Femra**	**Gjithsej**	**Femra**
Fëmijë AK	14	2		
Të rritur AK	20	10		
Të moshuar	60		35	
Romë	6			
Gjithsej	100	12	35	

Burimi: Bashkia Devoll, Maj 2026

Informacioni I detajuar mbi shërbimet e ofruara në të dy qendrat si edhe zhvillimi I tyre gjatë tre viteve të fundit paraqitet në figurën 4. Qendra ditore për të moshuarit është hapur në dy ambjente në godinën e nën prefekturës dhe në ambjentin e QSHKD. Aktualisht përfitojnë shërbim rreth 100 të moshuar falë projekteve të financuar nga UNDP, shërbim kafe, çaj dhe aktivitete argëtuese e krijuese. Gjithashtu qendra ofron edhe shërbim të thejshtë të kujdesit shëndetsor si fizioterapi, ndihmë në raste emergjence, infiermeri, matje tensioni, etj.



Burimi: Bashkia Devoll, Maj 2026

4.3.2. Përfituesit e shërbimeve të përkujdesit shoqëror

Përfituesit e shërbimeve në bashkinë Devoll janë kryesisht të moshuarit si edhe individët me aftësi të kufizuar, fëmijë dhe të rritur.

Tabela 14: Përfitues të shërbimeve të përkujdesit shoqëror

	Gjithsej	Femra	7-16 vjeç		25-65 vjeç		Mbi 65 vjeç	
			Gj	F	Gj	F	Gj	F
Fëmijë AK	14	2	14	2				
Të rritur AK	20	10			13	7	7	3
Të moshuar	60						60	
Romë	6	4	6	4				
Gjithsej	**100**	**16**	**20**	**6**	**13**	**7**	**60**	

Burimi: Bashkia Devoll, Maj 2026

Analiza e thelluar e shërbimeve të përkujdesit shoqëror e krahasuar me nevojën për shërbime si edhe situatën e përgjithshme të grupeve në kushte më kritike tregon se shkalla e plotësimit të nevojës për shërbime është rreth 3% sepse shërbimet janë të pamjaftueshme, ndërsa nevoja tepër e lartë, kryesisht për shkak të varfërisë, mungesës të të ardhurave si edhe problemeve të tjera sociale që shoqërojnë një vend në tranzicion.

Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese është 4%, gjë që dëshmon pamjaftueshmërinë e shërbimeve. Siç tregon figura 5, me përjashtim të tre grupeve që aktualisht marrin shërbime, për grupet e tjera në nevojë shërbimet nuk ekzistojnë. Edhe për grupet përfituese, shkalla e përfitueshmërisë është shumë e ulët, pra nevoja për shërbime të reja edhe për këto tre grupe, është e lartë.

Figura 5: Tregues jo të drejtëpërdrejtë të nevojës për shërbime.


Devoll	Nevoja për shërbime	Kapaciteti i ofruesve të shërbimeve	Përfitues të shërbimeve	Aplikime të papranuara	Plotësimi i nevojës për shërbim	Përfitues/ Aplikime gjithsej	Koeficienti i mjaftueshmërisë akomoduese
Pamjaftueshmëri ekonomike	2543	0	0	15	0%	0%	S'ka kapacitet
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	23	0	0	2	0%	0%	S'ka kapacitet
Fëmijë me aftësi të kufizuar	84	20	14	3	14%	82%	30%
Të rritur me aftësi të kufizuar	796	20	20	45	2%	31%	0%
Të rinj në kushte kritike	0	0	0	0	S'ka nevojë	S'ka përfitues	S'ka kapacitet
Gra në kushte kritike	177	0	0	2	0%	0%	S'ka kapacitet
Të moshuar	248	100	6	124	2%	5%	94%
Romë dhe Egjyptianë	0	0	95	0	100%	100%	S'ka kapacitet
Gjithsej	3871	140	135	191	3%	41%	4%

Burimi: Hartëzimi i Shërbimeve Shoqërore, 2025

4.3. 3 Burimet njerëzore, ofruese të shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

22 punonjës, përkatësisht 12 në bashki dhe 10 në institucione sigurojnë funksionimin e sistemit të përkujdesit shoqëror në bashkinë Devoll, duke ofruar përfitime monetare dhe shërbime ndaj qytetarëve në nevojë. I gjithë stafi është me arsim të lartë dhe pas universitar. Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit nuk është krijuar ende, ndërsa të gjitha strukturat e tjera, krijimi I të cilave është detyrim ligjor, duhet të plotësohen me staf që të funksionojnë me efiçensë. Regjistri elektronik gjithashtu nuk është populluar ende me të dhëna, për rrjedhojë, ende nuk përdoret, përfundimisht çështja e plotësimit të nevojave me staf të kualifikuar është dhe mbetet problem kritik.

Figura 6 ilustron treguesin e përfituesve mesatarisht për 1 punonjës të shërbimeve të përkujdesit shoqëror. Vërejmë se ndërsa 1 punonjës I institucioneve mesatarisht duhet të kujdeset për 48 individë në nevojë, 1 punonjës I bashkisë dhe institucioneve duhet të kujdeset për 275 persona në nevojë, nëse konsiderojmë të gjithë ata që I drejtohen bashkisë për ndihmë dhe mbështetje, dmth nëse përfshijmë edhe pagesat monetare. Treguesi I dytë është relativisht I lartë, duke konsideruar jo vetëm nivelin e kërkesës në aspektin sasior por edhe detyrimin për të realizuar standartet e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarit.



Burimi: Bashkia Devoll, Maj 2026

Për më tej, mbështetur në legjislacionin ekzistues mbi strukturat e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit duhet të ketë 1 punonjës për 6.000 banorë, ndërsa Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve duhet të ketë 1 punonjës për 3.000. Për rrjedhojë, nevoja për staf dhe kualifikim të mëtejshëm është evidente. Plani Social evidendon me saktësi nevojat edhe në këtë drejtim, përgjatë përpunimit të komponentit të burimeve njerëzore, institucionale e financiare në funksion të realizimit të objektivave të planit.

4.4. Përmbledhje: Grupet e përjashtuara ose në rrezik përjashtimi

Për të llogaritur individët në nevojë në bashkinë Devoll përdoren të gjitha të dhënat e paraqitura në tabelat nga 1 deri 13. Rezultatet e përmbledhura paraqiten në vijim, tek Tabela 12. Për të ndërtuar tabelën 12, si përmbledhje të të gjitha grupeve të analizuara, u ndërmorën disa veprime me qëllim që të dhënat të pasqyrojnë situatën reale. Kështu:

- ✓ Për të llogaritur Individë në nevojë, nga numri I përgjithshëm I aplikuesve të NE, u hoqën fëmijët, të moshuarit, gratë e vetme, individët me AK, që janë prëfitues të NE.
- ✓ Për të llogaritur individët AK, nga numri I përgjithshëm, u hoqën fëmijët me AK dhe të moshuarit.
- ✓ Grupet Gra, Fëmijë dhe të Moshuar në situatë kritike u llogaritën veçmas më lart.
- ✓ Tek grupi të "Papunë" zbriten gratë e papuna, të rinjtë dhe egjyptianët, sepse secila nga këto kategori është grup social I veçantë.

Tabela 15: Individë në situatë kritike dhe në nevojë për shërbime

Njësia administrative	INDIVIDË NË SITUATË KRITIKE									
	Përfitues NE	AK dhe Invalidë pune	Fëmijë	Gra	Të moshuar		Romë Egjyptianë	Të pastrehë	Të rinj	Gjithsej
Qendër Bilisht	392	150	192	172	123		35	15	7	1.086
Miras	570	153	259	181	304		0	20	12	1.499
Hoçisht	395	95	171	127	144		0	10	11	953
Progër	284	84	113	101	80		53	5	34	754
Bilisht	162	111	119	197	90		310	80	72	1.141
Gjithsej	**1.803**	**593**	**854**	**778**	**741**		**398**	**130**	**136**	**5.433**
Në përqindje	33%	11%	16%	14%	15%		7%	2%	2%	100%

Përfitojnë shërbime aktualisht		20	14		60		6			100
Në % ndaj numrit të përgjithshëm të individëve në nevojë		3.3	1.6		8					2
Individë në nevojë për shërbime	**1.803**	**573**	**840**	**778**	**681**		**392**	**130**	**136**	**5.333**
Në %	34	11	16	15	13		6	2.5	2.5	100

Burimi: Zyra për Shërbimet Shoqërore, Bashkia Devoll, Maj 2026

Analiza e grupeve në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror, identifikoi faktin se në territorin e Bashkisë Devoll janë 5.333 individë, që kanë të nevojshëm të paktën një formë të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Individët në nevojë ekonomike dhe sociale përbëjnë grupin më kriitk në raport me nevojën për shërbime, 34%; pasuar nga Fëmijët, 16%; Gratë, 15%; Të moshuarit, 13%, të rriturit AK, 11%, ndërsa grupet e tjera janë në përqindje të papërfillshme.

Tabela 16: Përmbledhje e individëve në nevojë për shërbime të identifikuara në raport me numrin e popullsisë

NJËSIA ADMINISTRATIVE	NR.POPULLSIE	NR. INDIVIDË NË NEVOJË PËR SHËRBIME KUJDESI SHOQEROR	%
Qendër Bilisht	8.314	1.086	13%
Miras	9.380	1.499	16%
Hoçisht	6.549	953	15%
Progër	5.678	754	13%
Bilisht	10.382	1.141	11%
Gjithsej	**40.303**	**5.433**	**13%**

Burimi: Bashkia Devoll, Maj 2026.

Siç tregon tabela 13% e popullsisë është në nevojë për shërbime. Përqindja e personave në nevojë në Hoçisht dhe në Miras është më e madhe se sa mesatarja e bashkisë, në Qendër Bilisht dhe Progër është sa mesatarja e bashkisë, ndërsa në Bilisht është më e ulët se sa mesatarja e bashkisë.

E gjithë analiza dukshëm argumenton renditjen si vijon të grupeve mbështetur në analizën sasiore të të dhënave:

1. Përfitues NE
2. Fëmijë
3. Gra
4. Të moshuar
5. Individë me AK dhe Invalidë pune
6. Romë dhe Egjyptianë
7. Të rinj
8. Të pastrehë

5. Vlerësimi cilësor I nevojës për shërbime të përkujdesit shoqëror

Mbështetur në Udhëzimin[2] si edhe metodologjinë e ndërtuar për identifikimin e grupeve më në nevojë kritike dhe formulimin e objektivave strategjike të Planit Social, u realizua edhe vlerësimi cilësor I nevojave, nëpërmjet Pyetsorit 2 si instrument I vlerësimit (Shtojcë 1), rezultatet e të cilit paraqiten tek Tabela 17.

Tabela 17: Grupet më të përjashtuara dhe nevojat më kritike të tyre.

Grupet më të përjashtuara sipas prioritetit	Nevojat më kritike
1. Të moshuar	Vështirësi në trajtimin shëndetsor, braktisja
2. Fëmijë AK	Mungesa e shërbimeve rehabilituese dhe riintegruese.
3. Gra në nevojë kritike	Papunësia, nevoja për riintegrim
4. Të rritur AK	Mungesa e shërbimeve rehabilituese dhe riintegruese.
5. Individë të familjeve në nevojë kritike ekonomike	Mungesa e të ardhurave

Pjesa e dytë e pyetsorit synonte identifikimin e shërbimeve më të nevojshme për grupet më të përjashtuara ose në rrezik përjashtimi. Përpunimi i të dhënave tregoi se “Shërbimet në familje” konsiderohen si shërbimi më kritik për bashkinë Devoll. Rezultatet janë përmbledhur tek Tabela 18.

Tabela 18: Shërbimet më të nevojshme në bashkinë Devoll.

Shërbimet më të nevojshme sipas prioritetit	Grupi përfitues
1. Shërbime në familje.	Të moshuar, Fëmijë dhe të Rritur AK, Të varfër
2. Shërbime në situatë emergjente	Të moshuar, Fëmijë dhe të rritur AK
3. Shërbime në qendër ditore	Të moshuar, Fëmijë AK, Gra
4. Shërbime në strehëz	Moshuar, Fëmijë dhe të Rritur AK
5. Shërbime komunitare	Fëmijë dhe të Rritur AK

Diskutimet me grupet e interesit përcaktuan prioritetet si vijojnë:

[2] Guide for Local Social Plan in Albania, Shkurt 2025

1. Ndërtim dhe funksionim i modelit të shërbimeve në familje për: Të moshuar, Fëmijë dhe të Rritur AK, Të varfër.
2. Ndërtim dhe funksionim i një strehëze për persona në nevojë emergjente: Të moshuar, Fëmijë në nevojë për mbrojtje, Gra në nevojë për mbrojtje.

Duke ju referuar shportës së shërbimeve shërbimeve të kujdesit shoqëror në përputhje me ligjin 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM 518, datë 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar"[3], nevojat për shërbime të kujdesit shoqëror prezantohen në tabelën 19.

[3] *Aksesuar nga http://www.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%20132/VKM%20nr.%20518,%20date%204.9.2018.pdf*

Tabela 19. Individët në nevojë dhe tipet e shërbimeve të mundshme sipas shportës së shërbimeve

INDIVIDE NË NEVOJË PËR SHËRBIME	BASHKIA	TIPET E SHËRBIMEVE SIPAS SHPORTËS
Gra në nevojë për mbrojtje	778	*1. Shërbimi i këshillimit me telefon ose on-line,* shërbimi i ofruar nëpërmjet linjës telefonike 24 orë në 7 ditë të javës, për mbështetjen, këshillimin në krizë dhe referimin e rasteve të dhunës në familje*;* *2. Shërbimi i emergjencës 72 orë,per* viktima të dhunës në familje dhe fëmijët që kanë nevojë për asistencë të menjëhershme për shkak të një situate që u kërcënon jetën dhe shëndetin, të cilëve u sigurohet minimalisht në mënyrë të menjëhershme akomodimi, ushqimi dhe mjedisi i mbrojtur. 3.*Shërbimi i strehimit të mbrojtur per* viktimat e dhunës në familje, viktimave të trafikimit të cilët nuk kanë një strehë.
Fëmijë në situatë kritike në nevojë për mbrojtje	854	*1. Shërbimi i këshillimit me telefon ose on-line,* shërbim i ofruar nëpërmjet linjës telefonike 24 orë në 7 ditë të javës, për mbështetjen, këshillimin në krizë dhe referimin e rasteve të dhunës *2. Shërbimi i përkujdesjes alternative për fëmijët pa kujdes prindëror, per* zhvillimin, arsimimin, shëndetin dhe mirëqenien e fëmijës kur nuk është në interesin më të lartë të tij të qëndrojë në një mjedis familjar të caktuar, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi. *3. Qendrat ditore për fëmijë të familjeve me probleme social-ekonomike*; 4. *Qendrat ditore për fëmijë me aftësi të kufizuara;* *5. Shërbime zhvilluese dhe rehabilituese* për fëmijë me çrregullime të zhvillimit; me prapambetje mendore; me çrregullime në komunikim; në nevojë për aftësim fizik; *6. Shërbimi i emergjencës 72 orë* per fëmijët pa kujdes prindëror ose të dhunuar, fëmijë të rrugës, të shfrytëzuar, të abuzuar dhe fëmijë me aftësi të kufizuara.

Moshuar	741	*1. Shërbimet në familje* për të moshuar të cilët e kanë të pamundur të marrin shërbime ditore komunitare apo rezidenciale, të cilët e kanë të pamundur të kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestari /ndihmësi personal. *2. Qendra ditore* për të moshuarit;
Persona me aftësi të kufizuara mbi 18 vjeç dhe invalidë pune	593	*1. Shërbime rehabilituese* per personat në nevojë për aftësim fizik; 2. *Shërbimet në familje* për persona me aftësi të kufizuara, të cilët e kanë të pamundur të marrin shërbime ditore komunitare dhe qe e kanë të pamundur të kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestari /ndihmësi personal; *3. Shërbimi i strehimit të mbrojtur* per personat me aftësi të kufizuara, të cilët nuk kanë një strehë.
Individë mbi 18 vjeç përfitues të ndihmës ekonomike	1.803	1. *Program për fuqizimin ekonomik*. *2. Informimi dhe këshillimi* për punësim për përmirësimin e situatës së individit, duke e orientuar rreth mundësive më të përshtatshme për nevojat e tij.
Gjithsej	4.818 12% e popullsisë	

6. Fushat strategjike në të cilat duhet të ndërhyjë bashkia nëpërmjet Planit Social 2027-2030

6.1. Prioritetet, qëllimi dhe objektivat

Prioritet 1: Ndërtim dhe funksionim i modelit të shërbimeve në familje për: Të moshuar, Fëmijë dhe të Rritur AK, Të varfër.

Prioritet 2: Ndërtim dhe funksionim i një strehëze për persona në nevojë emergjente: Të moshuar, Fëmijë në nevojë për mbrojtje, Gra në nevojë për mbrojtje.

Qëllimi Strategjik: Të sigurohet mbrojtje dhe mbështetje e specializuar për grupet më të përjashtuara, me synim përmirësimin e mirëqenies, autonomisë dhe përfshirjes së tyre sociale, nëpërmjet zhvillimit të një sistemi të qëndrueshëm të shërbimeve të kujdesit social, që garanton akses të barabartë në shërbime sociale të integruara dhe cilësore në familje, në komunitet dhe në situata emergjence.

Objektivat:

Objektivi Strategjik 1: Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit social me bazë familjen dhe komunitetin për grupet në nevojë, nëpërmjet ndërtimit dhe funksionimit të modelit të shërbimeve në familje për të moshuar, fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara, si dhe familje në varfëri.

Objektiv Specifik 1: Organizimi i shërbimeve në familje për të moshuar
Objektiv Specifik 2: Organizimi i shërbimeve në familje për individë me AK
Objektivi Specifik 3:Organizimi i shërbimeve në familje për individë në nevojë ekonomike
Objektivi Specifik 4: Rritja e kapaciteteve të bashkisë dhe partnerëve të saj për ofrimin e shërbimeve cilësore.

Objektivi Strategjik 2: Forcimi i mekanizmave vendorë të mbrojtjes emergjente dhe kujdesit social për personat në situata rreziku, nëpërmjet ndërtimit dhe funksionimit të një strehëze për persona në nevojë emergjente.

Objektivi Specifik 1: Përmirësimi i shërbimit të emergjencës për individë në nevojë
Objektivi Specifik 2: Ngritja e një strehëze për mbrojtjen dhe kujdesin social për persona në situatë rreziku.
Objektivi Specifik 3: Sigurimi i mbrojtjes dhe shërbimeve bazë jetësore për fëmijë të mitur të pashoqëruar.

6.2.Kosto e përgjithshme e Planit të Shërbimeve Sociale, 2027-2030

Objektivat strategjike dhe specifike	Kosto e përgjitshme	Periudha/Viti			
		2027	2028	2029	2030
Objektiv Strategjik 1	**70,260,000**	**9,180,000**	**20,360,000**	**20,360,000**	**20,360,000**
Obj.Sp. 1.1	21,000,000	3,000,000	6,000,000	6,000,000	6,000,000
Obj.Sp.1.2	21,000,000	3,000,000	6,000,000	6,000,000	6,000,000
Obj.Sp.1.3	18,000,000	3,000,000	5,000,000	5,000,000	5,000,000
Obj.Sp.1.4	10,260,000	180,000	3,360,000	3,360,000	3,360,0000
Objektiv Strategjik 2	**49.564.356**	**10.370.464**	**18.266.964**	**10.463.464**	**10.463.464**
Obj.Sp. 2.1	19,689,500	5,000,000	4,896,500	4,896,500	4,896,500
Obj.Sp.2.2	16,393,000	2,000,000	10,000,000	2,196,500	2,196,500
Obj. Sp. 2.3	13,481,856	3,370,464	3,370,464	3,370,464	3,370,464
Gjithsej	**119.824.356**	**19.550.464**	**38.626.964**	**30.823.464**	**30.823.464**

7. Plani i veprimit

Objektivi Strategjik 1: Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit social me bazë familjen dhe komunitetin për grupet në nevojë, nëpërmjet ndërtimit dhe funksionimit të modelit të shërbimeve në familje për të moshuar, fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara, si dhe familje në varfëri. **Kosto e përgjithshme e Objektivit 1 : 70,260,000 lekë për të gjithë periudhën e parashikuar të Planit të Veprimit**				
AKTIVITETET	**AKTORËT PËRGJEGJËS**	**AFATI**	**BURIMI I FINANCIMIT**	**KOSTO**
Objektivi specifik 1.1: Organizimi i shërbimeve në familje për të moshuar në nevojë për mbrojtje **Përfitues: 50 të moshuar në nevojë për mbrojtje** **Kosto e Objektivit Specifik 1.1: 21,000,000 për të gjithë periudhën e veprimit të planit.** **Baza ligjore: Plani Kombëtar mbi Moshimin, Ligj nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë.**				
1.1.1.Identifikimi i të moshuarve dhe vlerësimi i nevojave të tyre.		3m I 2027		Pa kosto
1.1.2. Hartimi i praktikave të		3m II 2027		Shpenzime për hartimin e praktikave: Grup ekspertësh (2) për 25 ditë

shërbimit dhe manualeve përkatës dhe kualifikim I stafit	Drejtoria e Shërbimeve Shoqërore		Bashkia nga "Të ardhura të vetat" Bashkia nga "Fondet e Pakushtëzuara" Bashkia nga "Fondi Lokal Social dhe Fondi qendror social".	2*25 ditë*Lekë20.000/ditë Lekë 1,000,000 Shpenzime për trainim stafi (2 trainime, secili 5 ditë): 10 ditë *20 persona*10,000 lekë në ditë=2,000,000 (është përfshirë edhe kosto për 2 trainerët). Kosto e plotë për aktivitetin 3,000,000 lekë
1.1.3. Përzgjedhja e një ekipi prej 5 punonjësish që do të organizojnë shërbimin.		6 m II 2027		Pa kosto
1.1.4. Sigurimi i shërbimit në familje për 50 persona, 2 herë në javë, nga një grup prej 5 personash.		2028 2029 2030		Shpenzime për paga: 5 persona*70,000lekë/muaj*12 muaj =4,200,000 në vit Shpenzime për trajtimin e të moshuarve (artikuj higjenike, argëtim, kafe.fruta etj): 50*3,000 lekë në muaj*12 muaj = Lekë 1,800,000 lekë në vit. Shpenzime vjetore gjithsej: 6,000,000 lekë. Kosto e plotë për aktivitetin gjatë periudhës 2028-2030 (3 vite) 3*6,000,000=18,000,000 lekë.
Objektivi specifik 1.2: Organizimi i shërbimeve në familje për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuar. **Përfitues: 30 fëmijë dhe 20 të rritur me aftësi të kufizuar**				

Kosto e Objektivit Specifik 1.2: 21,000,000 për të gjithë periudhën e veprimit të planit.

Baza ligjore: Ligji Nr.8098, datë 28.03.1996 "Për statusin e të verbërit", Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", Ligji Nr.7889, datë 14.12.1994, "Statusi i invalidit ", Ligj Nr.18/2017 "Për të drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës", Ligj nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë, Vendim nr. 148, datë 13.3.2018 " Për përcaktimin e rregullave të menaxhimit të rasteve, koordinimit, referimit….".

1.2.1. Identifikimi i fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuar dhe vlerësimi i nevojave të tyre, si edhe identifikimi sipas njësive administrative.	Drejtoria e Shërbimeve Shoqërore NjMF Drejtoria e Sigurimeve Shoqërore	3m I 2027	Bashkia nga "Të ardhura të vetat" Bashkia nga "Fondet e Pakushtëzuara" Bashkia nga "Fondi Lokal Social dhe Fondi qendror social".	Pa kosto
1.2.2. Hartimi i praktikave të shërbimit dhe manualeve përkatës dhe kualifikim I stafit		3m II 2027		Shpenzime për hartimin e praktikave: Grup ekspertësh (2) për 25 ditë 2*25 ditë*Lekë20.000/ditë Lekë 1,000,000 Shpenzime për trainim stafi (2 trainime, secili 5 ditë): 10 ditë *20 persona*10,000 lekë në ditë=2,000,000 (është përfshirë edhe kosto për 2 trainerët). Kosto e plotë për aktivitetin 3,000,000 lekë
1.2.3. Përzgjedhja e një ekipi prej 5		6m II, 2027		Pa kosto

punonjësish që do të organizojnë shërbimin.				
1.2.4. Sigurimi i shërbimit në familje për 50 persona, 1 herë në javë, nga një grup prej 5 personash.		2028 2029 2030		Shpenzime për paga: 5 persona*70,000lekë/muaj*12 muaj =4,200,000 në vit Shpenzime për trajtimin e përfituesve (materiale higjenike, didaktike dhe argëtuese): 50*3,000 lekë në muaj*12 muaj = Lekë 1,800,000 lekë në vit. Shpenzime vjetore gjithsej: 6,000,000 lekë. Kosto e plotë për aktivitetin gjatë periudhës 2028-2030 (3 vite) 3*6,000,000=18,000,000 lekë.

Objektivi specifik 1.3: Organizimi i shërbimeve në familje për individë në nevojë ekonomike

Përfitues: 100 familje

Kosto e Objektivit Specifik 1.3: 18,000,000 për të gjithë periudhën e veprimit të planit.

Baza ligjore: Ligji Nr. 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore"
Urdhër nr. 624, datë 20.08.2016 "Për miratimin e Planit Operacional për punësimin e anëtarëve në moshë aktive pune të skemës së ndihmës ekonomike 2019-2024, VKM nr. 518, date 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar".

1.3.1. Identifikimi i familjeve, si edhe analiza e mundësive të tregut të punës duke konsideruar nevojat e familjeve dhe rrethanat specifike të tyre.	Zyra e Punësimit Drejtoria e Shërbimeve Shoqërore NjMF	3m I 2027	Bashkia nga "Të ardhura të vetat" Bashkia nga "Fondet e Pakushtëzuara" Bashkia nga "Fondi Lokal Social dhe Fondi qendror social".	Pa kosto
1..3.2. Përgatitja e procedurave, rregulloreve dhe kritereve të përzgjedhjes të familjeve		3mII 2027		Pa kosto
1.3.3.Ofrim i formimit profesional dhe kualifikimit për nxitjen e vetëpunësimit të individëve të aftë për punë, si edhe nxitjen e sipërmarrjes së vogël dhe/ose familjare		3m II dhe III, 2027		5 kurse formimi nga 1 javë secili, 20 pjesëmarrës secili. Kosto për 1 pjesëmarrës 1 ditë 5,000 lekë(përfshirë koston e lektorëve) Kosto për 1 kurs: 600,000 lekë. Kosto e plotë e të gjitha kurseve: 5*600,000=3,000,000 lekë
1.3.4. Sigurimi i shërbimit në familje për 50 persona, 1 herë në javë, nga një grup prej 5 personash.		2028 2029 2030		Shpenzime për trajtimin e përfituesve (blerje materiale dhe paisje për fillimin e biznesit ose ndihmë familjare në rastet e personave jo në moshë pune si edhe ndihmë me materiale didaktike për

				fëmijët) = 100*5,000,000 lekë në vit për familje Shpenzime vjetore gjithsej: 5,000,000 lekë. Kosto e plotë për aktivitetin gjatë periudhës 2028-2030 (3 vite) 3*5,000,000=15,000,000 lekë.
Objektivi specifik 1.4: Rritja e kapaciteteve të bashkisë dhe partnerëve të saj për ofrimin e shërbimeve cilësore **Përfitues: 20 punonjës të bashkisë, sektori i shërbimeve sociale, 10 ofrues të shërbimeve sociale jashtë bashkisë** **Kosto e objektivit specifik 1.4: 10,260,000 lekë për të gjithë periudhën** **Baza ligjore: Ligj nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë, Ligji Nr. 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", Ligj nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë, Vendim nr. 148, datë 13.3.2018 " Për përcaktimin e rregullave të menaxhimit të rasteve, koordinimit, referimit….".**				
1.4.1.Rritje e numrit të punonjësve socialë me pesë punonjës, nga një për secilën njësi.	Drejtoria e Shërbimeve Shoqërore	6m I 2027	Bashkia nga "Të ardhura të vetat" Bashkia nga "Fondet e Pakushtëzuara"	Shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore për 5 punonjës: 5 punonjës*50,000lekë në muaj*12 muaj =3,000,000 lekë në vit. Kosto e plotë për periudhën 2028-2030: 9,000,000 lekë
1.4.2. Ndërtimi I bazës të të dhënave të operatorëve të shërbimeve sociale, publikë dhe jo publikë.				Pa kosto

1.4. 3.Organizim kurs formimi dhe riformimi profesional për të gjithë punonjësit e bashkisë që operojnë me çështjet e shërbimeve sociale.(kurs 3 ditor, çdo vit)		2027 2028 2029 2030	Bashkia nga "Fondi Lokal Social dhe Fondi qendror social".	4 kurse gjithsej 8 lektorë në secilin kurs 20 pjesëmarrës Kosto 1 kurs:180,000 lekë /vit, Kosto e plotë për 2027-2030: 720,000 lekë
1.4.4. Program trainimi "Rritja e fondeve nëpërmjet hartimit dhe menaxhimit të projekteve"		2028 2029 2030		3 kurse për 3 vite (2028-2030) 6 lektorë në secilin kurs 20 pjesëmarrës Kosto 1 kurs:180,000 lekë Kosto e plotë për 2028-2030: 540,000lekë

Objektivi Strategjik 2: Forcimi i mekanizmave vendorë të mbrojtjes emergjente dhe kujdesit social për personat në situata rreziku, nëpërmjet ndërtimit dhe funksionimit të një strehëze për persona në nevojë emergjente.

Kosto e përgjithshme e Objektivit 2 : lekë për të gjithë periudhën e parashikuar të Planit të Veprimit

AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO
Objektivi specifik 2.1: Përmirësimi i shërbimit të emergjencës për individë në nevojë **Përfitues: 200 individë në nevojë emergjente (gra, fëmijë, individë me AK, të varfër).**				

Kosto e Objektivit Specifik 2.1: 19,689,500 lekë për të gjithë periudhën e veprimit të planit.

Baza ligjore: Ligji Nr. 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", Ligj nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë, Vendim nr. 148, datë 13.3.2018 " Për përcaktimin e rregullave të menaxhimit të rasteve, koordinimit, referimit….".

2.1.1.Identifikimi i individëve në nevojë. Ndërtimi i bazës të të dhënave		**2027**	**Pa kosto**
2.1.2. Identifikimi i ofruesve të shërbimeve ekzistuese si edhe i kapaciteteve të shërbimeve, me qëllim lehtësimin e menaxhimit të rasteve të individëve në nevojë.		**2027**	
2.1.3.Vënia në funksionim e Regjistrit të Dixhitalizuar të Individëve në nevojë për shërbime sociale.		**3mI** **2028**	Kontraktim specialist IT për vënien në funksionim të Regjistrit. Shpenzime për ekspertizën vetëm në vitin e parë, viti 2027 Kosto e ekspertizës: 2,551,750 lekë
2.1.4.Përshtatja dhe zgjerimi I mjediseve ekzistuese të qendrës 72 për të siguruar strehimin në rastet e	Drejtoria e Shërbimeve Shoqërore	6mII 2027 2028 2029 2030	Kosto operacionale: 2,196,500 lekë në vit Shërbim 24 orë: 3 punonjës Paga bruto mujore: All75,000 Kosto Vjetore e pagave: All 2,700,000 Kosto e plotë vjetore e aktivitetit: 4,896,500 lekë. Viti 2027: 2,448,250 lekë (6 muaj)

emergjencave për individë në nevojë.			Vitit 2028, 2029, 2030: 4,896,500 lekë secili
Objektivi specifik 2.2: Ngritja e një strehëze për mbrojtjen dhe kujdesin social për persona në situatë rreziku. **Përfitues: 100 individë në nevojë për mbrojtje, referim, trajtim dhe kujdes (gra, fëmijë, individë me AK, të varfër).** **Kosto e Objektivit Specifik 2.2: 16,393,000 lekë për të gjithë periudhën e veprimit të planit.** **Baza ligjore: Ligj nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë, Ligji Nr. 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", Vendim nr. 148, datë 13.3.2018 " Për përcaktimin e rregullave të menaxhimit të rasteve, koordinimit, referimit….".**			
2.2.1 Identifikimi i partnerëve të mundshëm lokalë për bashkëpunim në funksionimin e strehëzës (organizata jo fitimprurëse ose organizata private)	Drejtoria e Shërbimeve Shoqërore	3ml 2027	Pa kosto
2.2.2. Përgatitja projekt propozim dhe paraqitje tek donatorët për mbështetjen e ndërtimit të një strehëze		2027	

2.2.3.Miratimi i projektit në Këshillin Bashkiak	Këshilli Bashkiak	6mII 2027		
2.2.4. Sigurimi i financimit, nënshkrimi i marëveshjes	Kryetari i bashkisë	6mII 2027		
2.2.5.Përzgjedhja e stafit dhe/ose kualifikimi	Drejtoria e Shërbimeve Sociale në bashkëpunim me donatorin	2027	Donatori /Financuesi i Strehëzës (UNDP, UNICEF, EU)	Program i plotë kualifikimi (1 javë, 20 persona, specialistë të shërbimeve sociale, specialistë të trajtimit të rasteve të emergjencës, specialistë të mbrojtjes dhe sigurisë). Kosto e programit të trainimit: 1,000,000lekë
2.2.6. Hartimi i rregulloreve dhe standarteve të shërbimeve Hartimi i manualeve operacionale		2027		Kosto ekspertizë teknike: 2 ekspertë*20,000lekë/ditë*25 ditë=1,000,000lekë

2.2.7. Ndërtimi i strehëzës, përgatitja e kushteve për funksionimin e saj		2028		Kosto investimit: 10,000,000 lekë
2.2.8.Funksionimi i qendrës		2029 2030		Kosto operacionale për periudhën 2029 dhe 2030: 2,196,500 lekë secili vit.

Objektivi specifik 2.3: Sigurimi i mbrojtjes dhe shërbimeve bazë jetësore për fëmijë të huaj të mitur të pashoqëruar.

Përfitues: 50 fëmijë të pashoqëruar

Kosto e Objektivit Specifik 2.3: 13,481,856 lekë për të gjithë periudhën e veprimit të planit.

Baza ligjore: Ligj nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë, Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, Konventa për të Drejtat e Popullsisë Migratore.

2.3.1. Sigurim strehë, ushqim, veshmbathje, kujdes social dhe shëndetsor, mbrojtje ligjore si edhe plotësim nevoja të tjera themelore për fëmijë të mitur të pashoqëruar, tranzit në territorin kufitar.	Drejtoria e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror Drejtoria e Mbrojtjes Kufirit Ministria e Brendshme. Ministria e Drejtësisë	**2027** **2028** **2029** **2030**	**Donator/Financues i projektit të hartuar për këtë qëllim.**	**Kosto vjetore: 1,255,320** **Kosto e plotë e aktivitetit: 4*3,370,464= 13,481,856 lekë**

8. Plani I Integruar I Monitorimit dhe Vlerësimit

Synimet e formuluara sipas objektivave specifike të secilit objektiv të përgjithshëm.	**Baza e nisjes e vlerësimit**	**Përfitues**	**Mënyra e vlerësimit**	**Treguesit e vlerësimi**
Objektivi Strategjik 1: Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit social me bazë familjen dhe komunitetin për grupet në nevojë, nëpërmjet ndërtimit dhe funksionimit të modelit të shërbimeve në familje për të moshuar, fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara, si dhe familje në varfëri.	Viti 2026	20 Individë mbi 18 vjeç me AK dhe Invalidë, trajtim në familje. 30 fëmijë me AK 100 familje pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme dhe në situate kritike 50 të moshuar. 20 punonjës të rinj dhe ekzistues të bashkisë. 10 punonjës të ofruesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror.	Raport monitorimi nga ekipi i bashkisë, çdo 6 muaj. Raport vlerësimi nga ShSSh, Dega Korçë. Raport Vlerësimi përfundimtar nga ekipi i bashkisë si edhe ekspertëve të jashtëm, 6 muaj përpara përfundimit të afatit të planit, Prill-Qershor 2026	Numri i individëve që përfitojnë shërbime në familje. Niveli i kënaqshmërisë të përfituesve të shërbimit dhe familjarëve të tyre. Numri i punonjësve të shtuar, në Bashki për NjVNR në çdo njësi. Aktivizimi i sistemit MIS. Numri i kurseve të formimit dhe riformimit profesional për të gjithë punonjësit e bashkisë që operojnë me çështjet e shërbimeve sociale, si edhe sipas tematikave. Numri i pjesëmarrësve

				dhe sipas funksioneve.
Objektiv 2: Forcimi I mekanizmave vendore të mbrojtjes emergjente dhe të kujdesit social për persona në situata rreziku nëpërmjet ndërtimit dhe funksionimit të një strehëze për trajtimin e emergjencave.		200 individë në nevojë emergjente 100 individë në nevojë për mbrojtje, referim, trajtim, kujdes. 50 fëmijë të huaj të pashoqëruar	Raport vlerësimi nga ShSSh, Dega Korçë. Raport Vlerësimi përfundimtar nga ekipi i bashkisë si edhe ekspertëve të jashtëm, 6 muaj përpara përfundimit të afatit të planit, Prill-Qershor 2030	Numri i personave që aksesojnë shërbimet e emergjencës. Ndërtimi , funksionimi i Strehëzës si edhe shkalla e aksesimit nga qytetarët në nevojë kritike. Numri I personave të trajtuar nga Strehëza. Numri i fëmijëve të huaj të pashoqëruar të trajtuar nga Bashkia, sipas standarteve të shërbimeve sociale.

Shtojcë 1
Shtojcë 2
Shtojcë 3
Shtojcë 4